



Planuar / Doretuar Prilbena/Prodato Received/Delivered	23.06.2021	702	1	viti god year
Organ /Ijesta Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SHIMBICK	3286/2021		1/3	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS**

A.nr.409/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 409/2021 të datës 11.05.2021 të parashtruar nga grup ankuesish**

**të cilët me autorizim i**

**përfaqëson avokat kundër organit të punësimit Komuna e Shtimes, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.06.2021, mori këtë:**

**V E N D I M**

**Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.409/2021 e datës 11.05.2021, e parashtruar nga grup ankuesish të cilët me autorizim i përfaqëson avokati**

**A r s y e t i m**

**Ankuesit nëpërmjet përfaqësuesit të tyre me autorizim, më datë 11.05.2021 kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 2323/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensim të pagave jubilarë dhe shujtave ditore për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018 sipas Kontratës Kolektive të Kosovës të vitit 2015.**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.05.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Shtimes. ndërsa me datë 09.06.2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Shtimes se bashku me provat lidhur me çështjen në procedurë.**

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2323/2021 të datës 11.05.2021, të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.05.2021; Autorizimin nga**

Autorizimin nga për Avokat	për Avokat Autorizimin nga	Autorizimin nga për Avokat
Përgjigjen në kërkesë e datës 12.03.2021 nga Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Ankesave për Nëpunësit Publik për përfaqësuesin e ankuesve; Kërkesën për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes e datës 06.04.2021 nga ankuesit; Vërtetim i datës 25.03.2021 për ankuesin		
Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 15.03.2019; Vërtetimin e datës 25.03.2021 për ankuesin		
Vërtetimin e datës 01.03.2021 për ankuesen		
Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 15.03.2019; Vërtetimin e datës 25.02.2021 për ankuesin		
Vërtetimin e datës 25.02.2021 për ankuesin		
Akt Emërimit e datës 15.05.2012; Vërtetimin e datës 23.02.2021 për ankuesen		
Vërtetimin e datës 23.02.2021 për ankuesen		
Akt Emërimit e datës 29.02.2012; Përgjigjen në kërkesë të datës 09.06.2021; Kërkesën për informacion nga M.H. për B.SH i datës 24.05.2021; E-mailin nga B.SH. për M.H. i datës 24.05.2021; Përmirësimin e gabimit në aktin administrativ të datës 24.05.2021; Pliko me nr. R8791007 i datës 07.06.2021; E-mailin nga av. L.B. për C.Z. i datës 14.06.2021; E-mailin nga C.Z. për av. L.B. i datës 14.06.2021; Autorizimin nga		
për Avokat		
E-mail innga av.L.B. për C.Z. i datës 18.06.2021; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 15.03.2019; Vërtetimin e datës 22.03.2021; Vërtetimin e datës 22.03.2021; E-mailin nga C.Z. për av.L.B. i datës 18.06.2021;		

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesve është e pa bazuar, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, është konstatuar se të gjithë ankuesit janë të punësuar në Komunën e Shtimes.

Ankuesit më datë 06.04.2021, kanë parashtruar kërkesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Shtime, për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtës ditore për ditët e pranisë në punë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive për periudhën nga 01.01.2015 deri 31.12.2018. Ndërsa në përgjigje të kërkesës, Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Ankesave për Nëpunësit Publik, me datë 12.03.2021, ka njoftuar përfaqësuesin e autorizuar të ankuesve se sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nëpunësit civil paraqesin ankesë drejtpërdrejtë në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil.

Pas këtij njoftimi, ankuesit, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 11.05.2021 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtave ditore, për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018, sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo më shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.



Bazuar në këtë konstatim, dhe në kuptim të nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, Kolegji konstaton se kërkesa e ankuesve për realizimin e kompensimit të pagave jubilarë dhe shujtave ditore për vitin 2015, 2016, dhe 2017 është parashkruar, kështu që pretendimi ankimor i ankuesve mbi këtë bazë ligjore është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbi Kërkime për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda Nr. A.nr.409/2021**

Çlirim ZEKA

*Çlirim ZeKa*  
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

*Ardita Haxhnikaj*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesëve avokatit
- Kryetarit të Komunës së Shtimes;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Shtimes;
- Arkivit të KPMSHCK-së

